

P.nr.934/16

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, gjyqtari i vetëm gjykues Isuf Makolli, me procesmbajtësen Mihane Halabaku, në çështjen penale kundër të pandehurës: B.B nga f.sh C KK D, për shkak të veprës penale Mashtrimi nga neni 335 par.1 të KPRK-së, e akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë/Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr7330/15, të datës 26.02.2016, në shqyrtimin fillestar, të hapur, të mbajtur më datë 04.08.2016, në të cilin ishin prezent Prokurori i shtetit Shenaj Berisha, e pandehura, pas shqyrtimit, të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

E pandehura **B.B**, e bija e Xh dhe M, e gjinisë B, e lindur me dt.*data e lindjes* në fsh.C i Epërme KK D, ku edhe tani jeton, e martuar, pa fëmijë, ka të kryer Fakultetin e Infermierisë e papunë, e gjendjes së mesme ekonomike, shqitare, shtetase e Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTORE**Sepse:**

Me datë 11.09.2015, në Prishtinë, fillimisht në filialin e b.p.b, ne rrugën “B K” me qëllimin që vetit t’i sjell përfitim pasuror te kundërligjshëm, duke paraqitur fakte te rreme, e ka mashtruar dhe e ka venë në lajthim zyrtaren e B.P.B B.M, e pastaj e njëjta përsëri me datë 29.09.2015, ne Prishtinë, ne filialin e kësaj banke ne sheshin “Z P” po ashtu me qellim që vetit ti sjellë përfitim pasuror te kundërligjshëm duke paraqitur fakte te rreme, e ka mashtruar dhe e ka venë ne lajthim edhe zyrtaren e te njëjtës bankë, R.A, ne atë mënyre që te njëjtat i ka nxitë që veprojnë ne dëm te pasurisë se te dëmtuarës A.K, kur para tyre është prezantuar rrejshëm si A.K duke ia paraqitur edhe letërnjoftimin e saj numër *numer personal*, përmes te cilit ka arritur që ti tërheqë parat ne shume prej 75 euro nga llogaria e personit Xh.K, e që për tërheqjen e këtyre parave kishte autorizim e dëmtuara A.K, me ç’rast te dëmtuarës i ka shkaktuar dem, material ne shume prej 150 euro.

-me këtë kryer veprën Mashtrimi nga neni 335 par. 1 të KPRK-së

Andaj gjykata në bazë të neneve: 7, 17,21, 41, 43, 46, 50,51, 52 dhe 73, të KPRK-së, si dhe neneve 248 e 365 të KPPRK-së, të pandehurës, i përcakton:

DËNIM ME BURGM DHE GJOBË ME KUSHT

Dënim me burgim në kohëzgjatje prej (6) gjashtë muajve dhe Dënim me gjobë në shumë, prej 300.00 € (treqind euro), e të cilat dënime nuk do të ekzekutohen në afat prej 1(një) viti, në qoftë se e pandehura gjatë kësaj kohe nuk do të kryej veprë të re penale.

Obligohet e pandehura që ti paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës penale, sa behën sipas llogarisë, ndërsa në emër te paushallit gjyqësor të paguaj shumen prej 20(njëzetë euro),në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Palët e dëmtuara A(N)K, nga fshati N, Komuna P, B(Z)M, me vendbanim rr., V F” në P, dhe R(M)A, me vendbanim ne rrugën “N P” bl. B, kati . nr... lagjja Spitalit në P, për kërkesë pasurore-juridike udhëzohen ne kontest civil.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Prishtinë/Departamenti i Përgjithshëm me aktakuzën PP.II.nr7330/15, të datës 26.02.2016, e ka akuzuar të pandehurën B.B nga f.sh C KK D, për shkak të veprës penale Mashtrimi nga neni 335 par.1 të KPRK-së

Gjykata ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar, me datë 04.08.2016, në të cilën ishin të pranishëm prokurori i shtetit Sh.B, dhe e pandehura B.B, pas leximit të aktakuzës, e pandehura B.B deklaroi se e pranon fajësin për veprën penale për të cilën akuzohem sipas aktakuzës Mashtrimi nga neni 335 par.1. të KPK-së ,pendohem thellë për veprimet e mija ,i premtoi gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsëris vepra të tilla apo të ngjashme është hera e parë që kam rënë ndesh me ligjin, lus gjykatën që më rastin e shqiptimit të dënimit të më shqiptoi një dënim sa ma të butë.

Gjykata pas pranimit të fajësisë nga e pandehura ka marrë edhe mendimin e Prokurorit të Shtetit Sh.B deklaroi se pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurës mbetem ne tersi pranë aktit akuzues meqenëse e pandehura e ka pranuar fajësinë pranimi i fajësisë është konform dispozitave ligjore dhe është në përputhshmëri e provat të cilat ju kanë mbështetur kësaj aktakuze, andaj i propozoi gjykatës që të njëjtën ta shall fajtor dhe ta dënoi sipas ligjit.

Mbrojtësi i të pandehurës av. S.M deklaroi se pranimi i fajësisë është bërë pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtjen .E mbrojtura e jonë e ka të qartë se pranimi i fajësisë në të gjitha fazat e procedurës është rrethanë lehtësuese me rastin e matjes së dënimit. Ne si mbrojtje konsiderojmë se gjykata duhet të marr parasysh faktin se asnjëherë nuk ka kryer asnjë vepër penale ,sjelljen e sajë pas kryerjes së këtij veprimi dhe atë pasi që i ka siguruar mjetete pas 3 javësh ia ka kthyer palës së dëmtuar shumën prej 150 Euro ,gjithashtu gjykata duhet të merr parasysh edhe faktin se pala e dëmtuar nga momenti që e mbrojtura e ime e ka lajmëruar se i ka marr mjetet financiare nuk ju ka bashkangjitur ma ndjekjes penale .

Pas pranimit të fajësisë nga e pandehura për veprën penale për të cilën akuzohet sipas aktakuzës, dhe pas mendimit të prokurorit të shtetit, i cili u pajtua me pranimin e fajësisë nga e akuzuara, Gjykata bazuar ne nenin 248 të KPPRK-së, me aktvendim pranoi pranimin e fajësisë nga e pandehura, pasi u bind se e pandehura e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, po ashtu ky pranim është bërë vullnetarisht dhe i mbështetur në faktet e çështjes që përmban aktakuza, dhe se janë përmbushur kërkesat nga neni 248 i KPPRK-së.

Po ashtu, nga shkresat e lëndës, por edhe nga deklaratimet e palëve në procedurë, gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurës B.B, ekzistojnë të gjitha elementet e veprës penale Mashtrimi nga neni 335 par. 1 të KPRK-së, si dhe vërtetoi gjendjen faktike, të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, prandaj gjykata edhe e shpalli fajtorë të pandehurën, pasi që më parë gjeti se është penalisht përgjegjës.

Me rastin e përcaktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit ndaj të pandehurës, gjykata mori parasysh të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, kështu që ndaj të pandehurës gjykata mori në konsideratë rrethanat lehtësuese si: intensitetin e rrezikimit apo

të dëmtimit të vlerës së mbrojtur; sjelljen e mëparshme të kryesit të veprës penale; pranimin e fajit dhe sinqeritetin e treguar gjatë shqyrtimit fillestar, pendimin e thellë për veprimet e saja, kushtet dhe rrethanat në të cilat është kryer vepra penale; ndërsa gjykata nuk gjeti ndonjë rrethanë veçanërisht rënduese, prandaj të pandehurës i shqiptoi dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindje se dënimi i shqiptuar, i përgjigjet shkallës së rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale për të cilën edhe është shpallur fajtorë, si dhe shkallës së përgjegjësisë penale të të pandehurës, dhe se me dënimin e shqiptuar kundër saj, do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41, të KPRK-së.

Në rastin konkret, gjykata ka marrë në konsideratë se rreziku penal dhe vlera e dëmshme e veprës penale ka qenë relativisht e vogël dhe vepra penale nuk ka rezultuar me dëme të konsiderueshme të vlerës së mbrojtur.

Vendimi për udhëzimin e përfaqësuesit të palës së dëmtuar në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike u mur konform nenit 463 par.3 të KPPRK-së

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor, u mor në bazë të nenit 453, par. 1, të KPPRK-së.

Vendimi mbi kërkesën pasurore-juridike u muar në bazë të nenit nenit 463 par.2. të KPPRK-së.

Nga sa u tha më lart, dhe në bazë të nenienev të cekura më lartë dhe neneve 248 e 365, të KPPRK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM

P.nr.934/16 te dt. 04.08.2016

Procesmbajtëse,
Mihane Halabaku

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Isuf Makolli

UDHËZIMI JURIDIK:

Kundër këtij aktgjykimi, ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa bëhet përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.